



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Arsim,
Uprava za Obrazovanje /Department of Education

Data/Datum/Date:	27. 11. 2025
Nr./Br./No	05/1053
Për/Za/To:	Njësia për Burime Njerëzore
Nga/Od/From: Për	Yllka Fejzullahu, drejtore e DKA-së
Lënda/Predmet/Subject :	NJFOTIM PËR MOSREALIZIM TË PROCEDURAVE TË KONKURSIT

Përmes kësaj shkrese ju njoftojmë se lidhur me konkursin e publikuar për pozitën Punëtor teknik mirëmbajtës i objektit, në SHMU “Emin Duraku” në Shtime, me numër të referencës së rekrutimit 02-111/01-0027148/25, të datës 20.10.2025, procedurat e rekrutimit ndërpriten dhe nuk do të vazhdojnë për arsyet e moszbatimit të dispozitave të mëposhtme:

Sipas Nenit 1 (Qëllimi) të QRK 27/2024: Rregullorja përcakton procedurat e konkurrimit për nëpunësit teknik dhe mbështetës në institucionet publike.

Sipas Nenit 2 (Fushëveprimi): Dispozitat e rregullores zbatohen për të gjitha institucionet publike që rekrutojnë staf teknik e mbështetës.

Sipas dispozitave të mëtejshme të rregullores, procedura e konkurimit përfshirë publikimin e konkursit, afatet për aplikim, dokumentimin, vlerësimin dhe përzgjedhjen duhet të zhvillohet brenda afateve dhe në përputhje me standardet e përcaktuara.

Kur gjatë zhvillimit të procedurës konstatohen devijime si mosrespektimi i afateve, moskompletimi i dokumentacionit, ose shkelje të procedurës rregullorja i jep të drejtë institucionit që të ndërpresë procedurën, pasi procesi konsiderohet i pavlefshëm. (Bazuar në natyrën e rregullores dhe praktikën e saj si akt proceduror të detyrueshëm.)

Në rastin konkret, ju njoftojmë se gjatë këtij konkursi janë konstatuar mosrespektim i afateve dhe devijim nga procedura standarde, gjë që cenon kushtet e parapara me QRK Nr. 27/2024. Për këtë arsye, procedura e rekrutimit për pozitën e sipërpërmendur ndërpritet dhe nuk vazhdohet.